



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania




**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

# **RAPORTI I MONITORIMIT TË**

## **PJESËMARRJES POLITIKE, SOCIALE DHE EKONOMIKE TË TË RINJVE**

# **2023**



**Hulumtues**  
Era Sherifaj

**Kontribues**  
Jonida Alite

**Grafika dhe Faqosja**  
Enxhi Rexhepi



© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Tiranë, Shqipëri 2024

Ky publikim u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

# TABELA E PËRMBAJTJES

1

**HYRJE**

2

**TË DHËNA MBI PJESËMARRJEN  
POLITIKE, SOCIALE DHE EKONOMIKE  
TË TË RINJVE**

3

**ANALIZA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE  
PËRGJATË 8 VITEVE TË MONITORIMIT**

4

**REKOMANDIME**

5

**SHTOJCA 1 : METODOLOGJIA E STUDIMIT**





# HYRJE

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSH), prej vitit 2016 përgatit "Raportin e Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve" në Shqipëri.

Ky raport publikohet si një mekanizëm për të kuptuar përfshirjen e të rinjve në kontekstin politik, ekonomik dhe social në Shqipëri. Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mundësive për të rinjtë, përmes lentes së 25 indikatorëve të pjesëmarrjes sociale, ekonomike dhe politike.

- **Dimensioni politik** i referohet mundësive të të rinjve për përfshirje në proceset politike, për t'u zgjedhur në poste politike, për t'u informuar për punën e qeverisë, parlamentit dhe bashkive, si dhe për të marrë pjesë në rrjete rinore. Indikatorët e përzgjedhur për të matur pjesëmarrjen e të rinjve në këtë dimensionin përfshijnë prezencën e ministrave dhe zëvendësministrave të rinj në qeveri, deputetë të rinj në parlament dhe kryebashkiakë të rinj. Tregues të tjerë vlerësojnë disponueshmërinë e mjeteve online për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje të qeverisë, parlamentit dhe bashkive; ekzistencën e strukturave rinore në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe përfaqësimin e të rinjve në role drejtuese dhe vendimmarrëse në administratën publike në nivel lokal, specifiku në bashkitë e Shqipërisë.
- **Dimensioni ekonomik** i referohet shkallës së përfshirjes ose, në të kundërtën, përjashtimit të të rinjve nga tregu i punës. Ky dimension mat shkallën e aktivitetit, pjesëmarrjes në forcën e punës, punësimin, vetëpunësimin të të rinjve, shkallën e papunësisë dhe papunësisë afatgjatë, të rinjtë NEET (Të rinj 15-29 as në Punësim, as në Arsim ose Trajnim), si dhe shpenzimet totale të qeverisë për programet e nxitjes së punësimin.
- **Dimensioni social** i referohet pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën shoqërore. Ai vlerësohet në bazë të integritetit të të rinjve në komunitet nëpërmjet edukimit formal dhe joformal, apo mungesës së treguesve të përjashtimit të mundshëm të të rinjve nga jeta shoqërore - për shkak të varfërisë, varësisë nga sistemi i mirëqenies sociale apo kohës së kaluar në burg ose në institucionet e riedukimit. Indikatorët përkatësisht përfshijnë përqindjen e të rinjve në rrezik varfërie, të rinjve në burgje dhe të rinjve pjesë e sistemit të mirëqenies sociale. Në konsideratë janë marrë edhe tregues të lidhur me arsimin, si shkalla e shkrim-leximit, shkalla e regjistrimit dhe e diplomimit në arsimin e detyrueshëm, e mesëm, profesional dhe arsimin e lartë, si dhe përqindja e të rinjve me arsim të avancuar. Gjithashtu janë përfshirë në raportin e këtij viti, shpenzimet totale të qeverisë për programet e mbrojtjes sociale.

Raporti monitorimit është një mjet konkret që mund të përdoret nga institucionet shtetërore dhe OSHC-të për të identifikuar dhe trajtuar në mënyrë sistematike sfidat më urgjente të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në Shqipëri. Ai kontribuon në:

- krahasimin e të dhënave sipas indikatorëve kryesorë të pjesëmarrjes së të rinjve në tre dimensione: politik, ekonomik dhe social;
- monitorimin e progresit të pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri ndër vite;
- advokim për zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve.

Raporti për Shqipërinë për vitin 2023 ofron një analizë të të dhënave të mbledhura përmes hulumtimit dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse si: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave, si dhe 61 Bashkive në vend.

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit "Fuqizimi i Shoqërisë Civile: Rritja e Adaptueshmërisë së OSHC-ve dhe Angazhimit Publik për një Demokraci të Qendrueshme" zbatuar nga Partnerët Shqipëri, mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë.

Më parë raporti është përgatitur nga PSH në kuadër të projektit "Punësimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" i zbatuar në partneritet me Fondacionin "Ana dhe Vlade Divac" në Serbi, "Aleancën Rinore" në Maqedoninë e Veriut, organizatën "Prima" në Mal të Zi dhe "Fondacionin e Vullnetarëve të Komunitetit" në Turqi. PSH është anëtare e Rrjetit YouthHub për Ballkanin Perëndimor & Turqinë. Raportet kombëtare kontribuojnë në zhvillimin e Raportit Rajonal, duke pasqyruar situatën e të rinjve në vendet e sipërpërmendura.



---

**“Megjithëse vitet e fundit janë ndërmarrë shumë iniciativa të fokusuara tek të rinjtë, aksesimi i shërbimeve për ta mbetet i kufizuar ose sfidues, veçanërisht për të rinjtë që jetojnë në qytete më të vogla dhe zona rurale”**

---



# Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

INDIKATORËT	GJITHSEJ	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministra të Rinj* në Qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2023 <sup>1</sup>
Zëvendësministra të Rinj në Qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2023 <sup>1</sup>
Deputetë të Rinj në Parlament	1.40%	0.70%	0.70%	2023 <sup>1</sup>
Kryebashkiakë të rinj	0.0%	0.0%	0.0%	2023 <sup>1</sup>
Mjetet Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Qeverisë dhe Parlamentit	92%			2023 <sup>1</sup>
Mjetet Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Bashkive	95%			2023 <sup>1</sup>
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshillat/parlamentet/bordet) në nivel kombëtar	PO			2023 <sup>1</sup>
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshillat/parlamentet/sindikatat) në nivel lokal	98%			2023 <sup>1</sup>
Të rinj të Punësuar në Administratën Publike në Nivel Qendror	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 <sup>2</sup>
Të rinj të Punësuar në Administratën Publike në Nivel Lokal	10.5%	14.7%	8%	2023 <sup>3</sup>
Të Rinj në Pozicione Drejtuese dhe Vendimmarrëse në Administratën Publike në Nivel Qendror	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 <sup>3</sup>
Të Rinj në Pozicione Drejtuese dhe Vendimmarrëse në Administratën Publike në Nivel Lokal	6.10%	6.20%	6%	2023 <sup>3</sup>
% e Buxhetit të Bashkive Dedikuar Rinisë	2-3%			2023 <sup>3</sup>

\*Me të "Rinj" i referohemi grupmoshës 15-29 vjeç sipas ligjit për Rinnë 75/2019 në Shqipëri.

Në Vëmendje: përqindja e pozicioneve të mbajtura nga gratë dhe vajzat në (a) parlament dhe (b) qeverisje lokale.

[1] Hulumtim

[2] Kërkesë për Informacion pranë Departamentit të Administratës Publike, DAP

[3] Kërkesë për Informacion drejtuar 61 Bashkive të Shqipërisë

---

**“Prej vitit 2016,  
pjesëmarrja politike e të  
rinjve në Shqipëri vazhdon  
të jetë shumë e ulët, me  
përfaqësim minimal të të  
rinjve në pozicione  
drejtuese dhe  
vendimmarrëse”**

---





# Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

INDIKATORËT	GJITHSEJ	FEMËR	MASHKULL	VITI
Të rinj në Rrezik Varfërie	21.5%	23.4%	19.7%	2022 <sup>4</sup>
Të Rinj në Burgje	39.3%	0.4%	38.9%	2023 <sup>5</sup>
Të Rinj pjesë e Sistemit të Mirëqenies Sociale	19.1%			2023 <sup>6</sup>
Shkalla e Shkrim-Leximit	98.9%	99.1%	98.9%	2023 <sup>7</sup>
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Detyrueshëm	97%	96.9%	97.2%	'23-'24 <sup>8</sup>
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Mesëm	80.6%	77.3%	83.7%	'23-'24 <sup>8</sup>
Braktisja e Shkollës së Mesme	Nuk ka të dhëna			2023 <sup>9</sup>
Indeksi i Barazisë Gjinore në Arsimin e Mesëm	0.92%			2023 <sup>10</sup>
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin Profesional	14.4%	4.8%	23.8%	'23-'24 <sup>8</sup>
Të Rinj të Diplomuar në Arsimin Profesional	1.9%	0.6%	3.2%	'22-'23 <sup>8</sup>
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Lartë	21.3%	25.4%	17.2%	'23-'24 <sup>11</sup>
Të Rinj të Diplomuar në Arsimin e Lartë	23.6%	26.2%	19.7%	'22-'23 <sup>11</sup>
Të Rinj të me Arsim të Avancuar	31.6%	42.9%	20.1%	2023 <sup>8</sup>
Të Rinj që jetojnë nën Nivelin Minimal të të Ardhurave / nën Nivelin Minimal të Standardit të Jetesës	Nuk ka të dhëna			2023
Buxheti i Qeverisë për Programet e Mbrojtjes Sociale	Buxheti: 30,597,119,00 lekë Shpenzimet: 30,095,419,629 lekë			2023 <sup>12</sup>

[4] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), të dhëna të disponueshme për vitin 2022, të dhënat për vitin 2023 do të publikohen në dhjetor 2024

[5] Kërkesë për Informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

[6] Kërkesë për Informacion në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

[7] Hulumtim në zyrë sipas të Dhënave nga Cens 2023

[8] Të dhëna nga INSTAT dhe Cens 2023

[9] Kërkesë për Informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

[10] Hulumtim në zyrë

[11] Kërkesë për Informacion pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[12] Kërkesë për Informacion pranë Shërbimit Social Shtetëror



**“Mungesa e të dhënave konsistente për dimensionin social veçanërisht për normat e varfërisë dhe të rinjve në sistemin e mirëqenies sociale, mbetet ende një problem në vitin 2023”**





## Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

INDIKATORËT	GJITHSEJ	FEMËR	MASHKULL	VITI
Shkalla NEET ( Të Rinj As në Punësim, as në Arsimit apo Trajnim)	24.6%	25.6%	23.5%	2023 <sup>13</sup>
Indeksi i Barazisë Gjinore në NEET	1.09%	0.0%	0.0%	2023 <sup>14</sup>
Shkalla e Papunësisë e të Rinjve	22.2%	20.6%	23.6%	2023 <sup>13</sup>
Shkalla e Papunësisë Afatgjatë e të Rinjve	15%	12.5%	17.2%	2023 <sup>13</sup>
Shkalla e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës e të Rinjve	56.9%	52%	61.8%	2023 <sup>13</sup>
Shkalla e Punësimin të të Rinjve	44.2%	41.3%	47.2%	2023 <sup>13</sup>
Përqindja e të Rinjve që themeluan Biznesin e tyre me Mbështetjen Financiare të Shtetit	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 <sup>15</sup>
Përqindja e të Rinjve të Vetëpunësuar	15.1%	12.5%	17.5%	2023 <sup>13</sup>
Raporti i Papunësisë së të Rinjve ndaj Popullsisë Totale	48.8%	42.5%	50.7%	2023 <sup>14</sup>
Raporti i Punësimin të të Rinjve ndaj Popullsisë Totale	19.6%	20.1%	19.1%	2023 <sup>14</sup>
Të Rinjtë të Punësuar në Rrezik Varfërie (Rreziku për të qenë i varfër sipas statusit të punësimin)	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2023 <sup>13</sup>
Të Rinj 15-17 vjeç të Angazhuar në Punë	4.1%	1.2%	2.9%	2023 <sup>16</sup>
Shpenzimet për Programet Nxitjes së Punësimin	626.790.431 Lekë			2023 <sup>17</sup>

[13] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[14] Hulumtim në zyrë

[15] Kërkesë për informacion drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

[16] Kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

[17] Kërkesë për informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësisë

---

**“Në vitin 2023, sfidat ekonomike për të rinjtë janë rritur në përgjithësi për të dyja gjinitë, dhe veçanërisht për të rinjtë djem, duke shënuar për herë të parë një rënie në treguesit kryesorë, dhe një ndryshim të pazakontë në pjesëmarrjen e tyre”**

---



# ANALIZA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE GJATË 8 VITEVE TË MONITORIMIT

Në përgjithësi, disa indikatorë kanë ndryshuar si pozitivisht dhe negativisht ndër vite, por krahasuar me të dhënat e prezantuara në raportin e parë, tetë vite më parë, vërehet një përmirësim i dukshëm.

## Dimensioni i Pjesëmarrjes Politike

Pjesëmarrja politike e të rinjve në Shqipëri vazhdon të jetë shumë e ulët, me përfaqësim të kufizuar si në qeverisjen kombëtare ashtu edhe në atë vendore. Në vitin 2023, nuk kishte të rinj të emëruar si ministra, zëvendësministra apo kryetarë bashkie, duke nënvizuar mungesën e diversitetit të brezave në rolet drejtuese politike dhe vendimmarrëse. Ndërkohë që ekzistojnë struktura rinore dhe ka pasur progres në mjetet online për angazhimin digjital të të rinjve, këto masa ende nuk kanë sjellë një ndikim domethënës ose më shumë mundësi vendimmarrjeje për të rinjtë.

Përfaqësimi i të rinjve në pozicionin ministër, në Shqipëri mbetet inekzistent, me një përqindje të pandryshuar të emërimeve prej 0% ndër vite. Pavarësisht përmirësimeve të dukshme në përfaqësimin gjinor, ku gratë përbëjnë 69% të ministrave në qeveri që nga shtatori 2023, pas ndryshimeve në kabinetin qeveritar kjo shifër shënon një rënie nga 81% i vitit 2022. . Ndërkohë, mosha mesatare e ministrave mbetet 45.5 vjeç.

Në vitin 2023, numri i zëvendësministrave të rinj ra në 0 nga vetëm 1 në vitin 2022, duke treguar një trend të gjatë të pjesëmarrjes së kufizuar të të rinjve në këto role. Gratë aktualisht mbajnë 56% të posteve të zëvendësministrave, megjithatë mosha mesatare mbetet 47 vjeç, duke theksuar më tej mungesën e diversitetit të brezave.

Përfaqësimi në parlament është po aq shqetësues. Në vitin 2023, vetëm 1.4% e deputetëve ishin të moshës 15-29 vjeç, duke treguar një përfaqësim minimal dhe në rënie të të rinjve në proceset legjislative.

Në nivel lokal, asnjë i ri nuk është zgjedhur kryetar bashkie gjatë pesë viteve të fundit. Drejtimi i bashkive në vend mbetet i dominuar nga burrat (87%), ndërsa gratë përbëjnë vetëm 13%, dhe mosha mesatare e kryetarëve mbetet 47 vjeç. Megjithatë, zgjedhjet vendore të 2023 shënuan një ndryshim modest, duke prezantuar tetë kryebashkiakë të moshës 35-38 vjeç, duke sjell kështu një ndryshim të brezave në një peizazh drejtues që mbetet kryesisht statik. Ky ndryshim gradual tregon potencialin për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve nëse adresohen barrierat strukturore dhe kulturore.

Në nivel lokal, ndër vite nga 2016 në 2023, janë bërë përparime të rëndësishme në disponueshmërinë e mjeteve digjitale për pjesëmarrje, me një rritje të theksuar veçanërisht në dy vitet e fundit. Në vitin 2023, pothuajse të gjitha bashkitë kanë krijuar platforma online, si faqet e internetit (website) dhe llogaritë e rrjeteve sociale, që synojnë informimin dhe angazhimin e qytetarëve, përfshirë të rinjtë, në proceset vendimmarrëse. Në shumë raste, këto llogari menaxhohen nga kryetarët e bashkive dhe jo nga vetë bashkitë, duke pasur në fokus promovimin e aktiviteteve të tyre. Në mënyrë të ngjashme, shumica e institucioneve qeveritare në Shqipëri kanë adoptuar mjete online për të përmirësuar aksesin e publikut në informacion, me vetëm një ose dy përjashtime kur burime të tilla mbeten të padisponueshme. Ndërsa këto zhvillime shënojnë progres, fokusi themelor në promovimin e aktiviteteve dhe jo në përfshirjen kuptimplotë të publikut nënvizon nevojën për një zhvendosje drejt praktikave digjitale më pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse.

Strukturat rinore si në nivel kombëtar ashtu dhe lokal ekzistojnë për të nxitur angazhimin e të rinjve në jetën politike dhe sociale. Në nivel kombëtar, institucione si Agjencia Kombëtare e Rinisë, Këshilli Kombëtar Rinor dhe Kongresi Rinor Kombëtar luajnë një rol të rëndësishëm në fuqizimin e të rinjve dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në qeverisje dhe aktivitete të komunitetit. Këto institucione ofrojnë një platformë për advokim, ngritje kapacitetesh dhe influencim në politikat publike.

Në nivel lokal, Ligji për Rininë 75/2019 parashikon ngritjen e Këshillave Vendor Rinor (KVR) në të gjitha bashkitë e vendit. Deri në vitin 2023, 60 bashki në vend kanë ngritur KVR-të e tyre, duke reflektuar progresin në institucionalizimin e përfshirjes së të rinjve. Megjithatë, efektiviteti i këtyre strukturave në përmbushjen e roleve të synuara ndryshon nga njëra bashki në tjetrën, shpesh i kufizuar nga burimet e pamjaftueshme, kapaciteti i kufizuar ose mungesa e prioritizimit nga autoritetet lokale.

Për të arritur plotësisht potencialin e tyre, nevojitet një angazhim më i madh dhe më i qëndrueshëm për t'i pajisur këto këshilla me mjetet, mbështetjen dhe autonominë e nevojshme për të funksionuar si agjentë aktivë të fuqizimit të të rinjve dhe pjesëmarrjes qytetare. Pa përpjekje të tilla, këto struktura rrezikojnë të bëhen më shumë simbolike sesa transformuese. Gjithashtu, qendrat rinore dhe hapësirat multifunksionale shërbejnë si qendra për nxitur përfshirjen dhe fuqizimin e të rinjve, duke ofruar mundësi për ndërveprim social, zhvillim të aftësive dhe pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Struktura të tilla janë tashmë funksionale në disa qytete, shumë të tjera janë ende në ndërtim, ndërkohë që disa qytete nuk ekzistojnë fare, duke theksuar pabarazitë në akses dhe disponueshmëri midis bashkive.

Për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e të rinjve, është thelbësore që t'i jepet përparësi krijimit dhe funksionimit efektiv të këtyre strukturave në të gjitha bashkitë. Kjo përfshin alokimin e burimeve të mjaftueshme, sigurimin e programeve të ndryshme të përshtatura për nevojat lokale dhe nxitjen e mjediseve gjithëpërfshirëse që inkurajojnë përfshirjen aktive të të gjithë të rinjve, pavarësisht nga prejardhja e tyre socio-ekonomike ose gjeografike. Pa një qasje gjithëpërfshirëse për zgjerimin dhe mbështetjen e këtyre strukturave, potenciali i tyre për të nxitur angazhim dhe fuqizim kuptimplotë rrezikon të mos realizohet.

Bashkitë luajnë një rol kyç në fuqizimin e të rinjve në nivel lokal, por përpjekjet e tyre shpesh pengohen nga kufizimet strukturore dhe financiare. Me përjashtim të Bashkisë Tiranë, në shumicën e bashkive mungojnë drejtoritë e rinisë, të cilat i adresojnë çështjet që lidhen me rininë nëpërmjet departamenteve të tjera si arsimi, kultura apo shërbimet sociale. Kjo qasje e fragmentuar zbeh fokusin në iniciativat specifike të të rinjve dhe kufizon ndikimin e tyre të përgjithshëm.

Ndërkohë që shumë bashki kanë specialistë për rininë, vetëm një pjesë e vogël përcaktojnë buxhet të dedikuar për iniciativat rinore, që zakonisht është vetëm 2%-3% të buxhetit total. Edhe këto fonde të limituara zakonisht përfshihen në programe më të gjera, duke kufizuar më tej efektivitetin e tyre në adresimin e nevojave unike të të rinjve. Ky hendek financiar vjen nga disa faktorë, duke përfshirë kërkesën e ulët nga njësitë e fokusuara te të rinjtë, prioritetet konkurruese që lënë në hije nevojat e të rinjve, dhe burimet e kufizuara financiare për shkak të ardhurave të pamjaftueshme të bashkive.

Në lidhje me përfshirjen e të rinjve në institucionet lokale nëpërmjet punësimit në bashki, 10.5% e personelit të administratës publike në nivel bashkie janë të moshës 15-29 vjeç, ku vajzat përbëjnë shumicën e kësaj demografie. Megjithatë, prania e tyre në rolet drejtuese është dukshëm e ulët, me vetëm 6.1% të punonjësve të rinj që mbajnë pozicione si nënkryetar bashkie, drejtor ose përgjegjës sektori, 3.9% janë vajza. Përfaqësimi i të rinjve me aftësi të kufizuara është i ulët, me vetëm 1.2% të punonjësve të rinj të bashkive që identifikohen si të tillë, duke nënvizuar nevojën për praktika më gjithëpërfshirëse të punësimit.

Për sa i përket angazhimit politik të të rinjve, mungon transparenca nga partitë politike në lidhje me përfshirjen e tyre, pasi nuk kanë ofruar të dhëna për numrin e të rinjve aktivë në strukturat partiake. Takimet konsuluese zbulojnë një trend shqetësues: shumica e të rinjve tregojnë pak ose aspak interes për pjesëmarrjen politike, duke reflektuar një shkëputje të gjerë nga proceset tradicionale politike. Megjithatë, një nëngrup i të rinjve shpreh gatishmërinë për t'u angazhuar, veçanërisht në nivel lokal, megjithatë shumë përballen me barriera të konsiderueshme. Këto përfshijnë mungesën e udhëzimeve, mentorimit dhe stimujve për të naviguar në rrugën komplekse drejt politikës, duke vështirësuar pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë në politikë.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon një përpjekje të përbashkët për të krijuar një mjedis mbështetës që jo vetëm inkurajon përfshirjen e të rinjve, por gjithashtu eliminon barrierat që pengojnë përfshirjen e tyre politike. Kjo përfshin ofrimin e programeve të mentorimit, rritjen e transparencës brenda strukturave politike dhe nxitjen e një kulture që vlerëson dhe nxit pjesëmarrjen e të rinjve në qeverisje dhe vendimmarrje.



## Dimensioni i Pjesëmarrjes Sociale

Ndër vite, ka pasur kufizime të konsiderueshme në disponueshmërinë e të dhënave për indikatorë të caktuar brenda dimensionit të pjesëmarrjes sociale, veçanërisht në lidhje me përqindjen e të rinjve të varfër dhe atyre pjesë të sistemit të mirëqenies sociale. Këto kufizime limitojnë përpjekjet për të kuptuar dhe adresuar plotësisht sfidat socio-ekonomike me të cilat përballen të rinjtë.

Të dhënat tregojnë një reduktim të përgjithshëm të rrezikut të varfërisë tek të rinjtë, megjithëse mbeten dallime të dukshme gjinore. Vajzat janë vazhdimisht në një rrezik më të lartë varfërie sesa të rinjtë. Midis 2017 dhe 2022, përqindja e djemve në rrezik varfërie është ulur me 7.2%, ndërsa për vajzat ulja është vetëm 0.9%. Rreziku është veçanërisht i theksuar tek grupmosha 0-17 vjeç, ku 28.6% e vajzave në këtë kategori përballen me një probabilitet më të lartë varfërie.

Në Shqipëri, popullsia e të rinjve përballen me një rrezik varfërie pak më të lartë se popullsia e përgjithshme, me 21.5% të të rinjve në rrezik krahasuar me 20.6% të popullsisë totale. Këto shifra nënvizojnë vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë në arritjen e stabilitetit ekonomik. Adresimi i kësaj situate kërkon strategji të synuara që u japin përparësi politikave të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe moshës brenda kuadrit më të gjerë të mirëqenies sociale dhe përfshirjes ekonomike. Të dhënat e përditësuara mbi përqindjen e të rinjve në rrezik varfërie për vitin 2023 priten të publikohen në fund të dhjetorit 2024.

Të dhënat për përqindjen e të rinjve të varfër vijojnë të mos maten apo të sigurohen nga INSTAT dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë viteve 2017-2023. Në vitin 2023 u propozua një projektligj për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, deri më tani, nuk ka asnjë informacion publik të disponueshëm në lidhje me miratimin e këtij minimumi jetik ose vlerën e tij të specifikuar.

Gjithashtu, në vitin 2023, të dhënat për të rinjtë në sistemin e mirëqenies sociale vazhdojnë të jenë të pjesshme, me informacion të kufizuar për grupmosha të ndryshme, përveç atyre të moshës 15-29 vjeç. Nga tre programet e disponueshme të ndihmës sociale, të dhënat të kufizuara tregojnë se rreth 19.1% e totalit të përfituesve të ndihmës ekonomike i përkasin kategorisë së të rinjve të moshës 18-30 vjeç. Buxheti në dispozicion për programet e mbrojtjes sociale për vitin 2023 ka qenë në vlerën 30.597.119.000 lekë, me shpenzime në total prej 30.095.419.629 lekë.

Në vitin 2023, 39,3% e të burgosurve të trajtuar në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale janë të rinj. Është i dukshme një dallim i qartë gjinor, ku përqindja e të burgosurve djem është shumë herë më e lartë se e vajzave të burgosura. Numri i vajzave në burgje mbetet i papërfillshëm, duke filluar nga 0% në 0.4%, ndërsa përqindjet e djemve kanë shfaqur luhatje të konsiderueshme, duke arritur kulmin në 38.9% në vitin 2023. Përqindja më e lartë e të rinjve në burgje u regjistrua në vitin 2018 me 47.7%, dhe më e ulëta në vitin 2020 në 30%, e ndjekur nga një rritje konsistente gjatë tre viteve të fundit.



Ky trend ngre pyetje kritike në lidhje me faktorët socio-ekonomikë, arsimorë dhe të sistemit që kontribuojnë në përfshirjen e të rinjve në aktivitete kriminale dhe burgosjen e tyre të mëvonshme. Adresimi i këtyre çështjeve kërkon ndërhyrje të qëllimshme, duke përfshirë programe parandaluese, iniciativa për angazhimin e të rinjve dhe reforma brenda sistemit të drejtësisë për të reduktuar recidivizmin dhe për të ofruar alternativa ndaj burgosjes për të rinjtë që shkelin ligjin.

Shkalla e shkrim-leximit e të rinjve banues është e lartë, me 98.9% të të rinjve që dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. Ky tregues është pak më i lartë për vajzat (99.1%) krahasuar me djemtë (98.8%). Megjithatë, ka një kontrast të theksuar kur bëhet fjalë për të rinjtë me aftësi të kufizuara, pasi vetëm 63.4% e tyre dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, krahasuar me shkallën e përgjithshme të shkrim-leximit të të rinjve prej 98.9%. Ky hendek i rëndësishëm nënvizon barrierat e mëdha me të cilat përballen të rinjtë me aftësi të kufizuara për të aksesuar arsimin. Ndërkohë që pothuajse të gjithë të rinjtë në popullsinë e përgjithshme dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, më shumë se një e treta e atyre me aftësi të kufizuara nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, duke nxjerrë në pah një problem kritik në arritjen e gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë në arsim.

Kjo pabarazi nënvizon mangësi të sistemit në krijimin e mjediseve arsimore gjithëpërfshirëse që plotësojnë nevoja të ndryshme. Adresimi i kësaj çështjeje kritike kërkon një qasje të shumëanshme, duke përfshirë investim në infrastrukturë të aksesueshme, burime mësimore të përshtatura, trajnime të specializuara për mësuesit dhe politika që promovojnë në mënyrë aktive përfshirjen e të rinjve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm. Kapërcimi i këtij hendeku është thelbësor për të arritur një arsim të barabartë dhe për të nxitur pjesëmarrjen e plotë të të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe ekonomike.

Të dhënat për regjistrimin në arsimin e detyrueshëm tregojnë nivele të larta pjesëmarrjeje midis të rinjve të moshës 6-15 vjeç që jetojnë në Shqipëri, me një normë të përgjithshme regjistrimi prej 97.0%. Ka një diferencë të vogël gjinore: 50,5% e të rinjve të kësaj grupmoshe të regjistruar në arsimin e detyruar janë djem, 4% më shumë se vajzat (46,5%).

Në arsimin e mesëm, 80,6% e të rinjve të moshës 15-18 vjeç janë regjistruar në vitin 2023, ku djemtë përfaqësojnë 42,5% dhe vajzat 38%. Kur ndahen sipas gjinisë, 77,3% e vajzave të kësaj grupmoshe janë të regjistruara, krahasuar me 83,7% të djemve. Kjo tregon një hendek gjinor në pjesëmarrjen në arsimin e mesëm, ku të rinjtë kanë një shkallë më të lartë regjistrimi prej 6,4%.

Indeksi i barazisë gjinore (GPI) për regjistrimin e të rinjve në arsimin e mesëm është 0.92, duke treguar se për çdo 100 djem të regjistruar, janë 92 vajza të regjistruara, duke theksuar një inbalancë të lehtë, por të qëndrueshëm në favor të djemve.

Në arsimin e mesëm, 14,4% e të rinjve të moshës 15-18 vjeç zgjedhin arsimin profesional, me një diferencë të dukshme gjinore. Vetëm 4,8% e vajzave në këtë grupmoshë ndjekin arsimin e mesëm profesional, krahasuar me 23,8% të djemve të moshës 15-18 vjeç. Arsimi profesional duket më tërheqëse ose më i aksesueshëm për djemtë sesa për vajzat, për shkak të perceptimeve tradicionale që fushat e arsimit profesional janë më të përshtatshme për industrinë e dominuar nga djemtë.

Pjesëmarrja më e lartë e djemve sugjeron se arsimi profesional është ose më tërheqës ose më i arritshëm për ta, ndërkohë që vajzat mund të përballen me barriera si strukturore ashtu dhe kulturore. Këto përfshijnë ekspozimin e kufizuar në fusha të ndryshme profesionale, mungesën e modeleve pozitive në karrierat tradicionalisht të dominuara nga meshkujt dhe pritshmëritë shoqërore që i drejtojnë femrat drejt karrierave më akademike ose "femërore".

Për të adresuar këtë situatë është e nevojshme të sfidohen stereotipet gjinore, të zgjerohet diapazoni programeve profesionale, për të promovuar mundësi të barabarta. Përpjekjet duhet të përqendrohen gjithashtu në fushata informuese dhe sensibilizuese për të ndryshuar perceptimet për arsimin profesional, të shoqëruara me politika që stimulojnë dhe mbështesin të rejtat në ndjekjen e këtyre drejtimeve, duke siguruar që arsimi profesional të bëhet një opsion gjithëpërfshirës për të gjithë të rinjtë.

Në vitin 2023, vetëm 1.9% e të rinjve të moshës 19-24 vjeç përfunduan arsimin profesional në Shqipëri, ku shumicën e përbëjnë djemtë (1.5%) krahasuar me vajzat (0.3%). Megjithatë, pavarësisht numrit të ulët të vajzave të diplomuara, ato kanë një performancë më të mirë diplomimi sesa djemtë. Ndër studentët e regjistruar në programet profesionale 4-vjeçare në vitin 2019, 16,3% prej tyre u diplomuan me sukses në vitin 2023, ku 17,5% e vajzave përfunduan me sukses studimet krahasuar me 16,1% të djemve.

Këto shifra sugjerojnë se ndonëse femrat përballen me pengesa për t'u regjistruar në arsimin profesional, ato që regjistrohen kanë më shumë gjasa të përfundojnë me sukses programet e tyre në kohë. Ky trend nënvizon rëndësinë e adresimit të pabarazive në regjistrim dhe ndërmarrjen e masave të synuara për të inkurajuar më shumë të reja të ndjekin arsimin profesional. Përpjekjet mund të përfshijnë fushata ndërgjegjësimi, mundësi mentorimi dhe diversifikimin e fushave profesionale për të përfshirë programe që tradicionalisht lidhen me gratë, të shoqëruara me politika mbështetëse për të siguruar akses dhe pjesëmarrje të barabartë. Në këtë mënyrë, arsimi profesional mund të bëhet një alternativë e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë të rinjtë.

Shkalla e regjistrimit në arsimin e lartë në Shqipëri ka treguar stabilitet gjatë viteve të fundit, me luhajtje të vogla. Shkalla më e ulët e regjistrimit është shënuar në vitin 2020 (20.9%), ndërsa vitet në vijim kanë pësuar një rritje të lehtë duke arritur 21.3% në vitin 2023. Pavarësisht konsistencës së përgjithshme, është i dukshëm një hendek i vazhdueshëm gjinor, me vajzat që vazhdojnë të tejkalojnë numrin e djemve në regjistrimin në arsimin e lartë me 8.2%.

Edhe pse shkalla e regjistrimit e vajzave ka rënë nga kulmi i saj prej 28.1% në vitin 2016 në 25.4% në 2023, ato ende kanë një pjesëmarrje më të lartë krahasuar me djemtë. Pjesëmarrja më e lartë e vajzave në arsimin e lartë sugjeron që ato e perceptojnë atë si një rrugë thelbësore për avancimin në karrierë dhe mobilitet social, ndërsa djemtë mund të përballen me presione apo mundësi të ndryshme socio-ekonomike që i largojnë ata nga arsimi formal.

Në vitin 2023, 9,5% e të rinjve të diplomuar nga arsimi i lartë i përkasin grupmoshës 22-29 vjeç, duke reflektuar një trend në rënie në përqindjet e diplomimit në arsimin e lartë. Shkalla e përgjithshme e diplomimit është ulur nga 26% në vitin 2019, në 23.6% në vitin 2023, duke shënuar një zbritje prej 2.4% gjatë katër viteve. Kjo ulje prek të dyja gjinitë, por nënvizon pabarazitë e vazhdueshme, me vajzat që vazhdojnë të diplomohen me ritme dukshëm më të larta se djemtë –26.2% krahasuar me 19.7%.

Hendeku gjinor në normat e diplomimit sugjeron se ndërsa vajzat kanë më shumë gjasa të përfundojnë arsimin e lartë, sfidat e sistemit prekin të gjithë studentët. Për djemtë, faktorë të tillë si kërkesat e tregut të punës, pritshmëritë shoqërore ose presionet ekonomike mund të kontribuojnë në shkallë më të ulët të përfundimit të studimeve. Për vajzat, pavarësisht niveleve të larta të diplomimit, barrierat strukturore mund të pengojnë ende tranzicionin e tyre nga arsimi në punësim.

31,6% e të rinjve të moshës 25-29 vjeç kanë diploma dhe kualifikime në nivele të avancuara, si master apo doktoraturë. Kjo përfaqëson gati një të tretën e popullsisë në këtë grupmoshë, duke reflektuar një theks të fortë në arsimin e lartë formal si një rrugë për avancim profesional dhe personal. Vajzat kanë shumë më tepër gjasa të kenë arsim të avancuar, me 42.9% të vajzave të moshës 25-29 vjeç që mbajnë diploma në nivele të avancuara, krahasuar me vetëm 20.1% të djemve.



## Dimensioni i Pjesëmarrjes Ekonomike

Në vitin 2023, treguesit kryesorë ekonomikë për të rinjtë në Shqipëri tregojnë tendenca shqetësuese, veçanërisht për djemtë. Shkalla papunësisë dhe papunësisë afatgjatë janë rritur, ndërsa shkalla e punësimit dhe përqindja e vetëpunësuarve kanë rënë. Këto ndryshime tregojnë sfida në rritje për meshkujt e rinj në sigurimin e pozicioneve të qëndrueshme në tregun e punës. Ndërsa për të vajzat, vazhdon të ketë barriera të vazhdueshme, të cilat rezultojnë në nivele më të ulëta punësimi dhe pjesëmarrje në fuqinë punëtore krahasuar me kolegët e tyre djem.

Shkalla NEET (Të rinj jo në Arsim, Punësim ose Trajnim), megjithëse ka treguar një tendencë të lehtë në rënie nga viti 2016 deri në 2023, mbetet ende dukshëm e lartë në 24.6%, më shumë se dyfishi i mesatares së BE-së (11.2%).

Indeksi i barazisë gjinore (GPI) për NEET është 1.09, duke treguar një pabarazi të vogël gjinore, me më shumë vajza që janë jashtë arsimit, punësimit ose trajnimit krahasuar me djem në vitin e fundit. Në vitin 2023, shkalla NEET e vajzave u ul me 2.2%, duke ngushtuar hendekun gjinor nga 5.2% në vitin 2022 në 2.1%. Pavarësisht këtij progresi, vajzat ende përballen me më shumë barriera për pjesëmarrjen ekonomike sesa djemtë. Është interesante se në vitin 2023, shkalla e NEET për djemtë është rriur me 0.9%, një dukuri që ndodh për herë të parë, duke sugjeruar vështirësi në rritje për djemtë në aksesimin e arsimit ose mundësitë e punësimit.

Shkalla e papunësisë e të rinjve ka shfaqur një rënie të vazhdueshme gjatë viteve 2016-2022, por viti 2023 shënon një rritje të shkallës së papunësisë së të rinjve për herë të parë në tetë vjet. Kjo është veçanërisht e theksuar tek djemtë, shkalla e papunësisë e të cilëve u rrit me 2.9%, duke tejkaluar shkallën e papunësisë të vajzave për herë të parë në katër vjet. Ndërkohë, shkalla e papunësisë e vajzave ka qenë më e qëndrueshme, me luhatje të lehta ulje, që tregojnë një përmirësim gradual të mundësive të punësimit për vajzat.

Papunësia afatgjatë e të rinjve është rritur gjatë tre viteve të fundit, me të dyja gjinitë që kanë pësuar rritje në vitin 2023. Papunësia afatgjatë arriti në 15% në 2023, duke shënuar një rritje të ndjeshme prej 2.5% krahasuar me vitin 2022 (12.5%), dhe përfaqëson normën e dytë më e lartë që nga viti 2016 (16.7%). Djemtë janë prekur në mënyrë joproporcionale, ku shkalla e papunësisë afatgjatë për ta është 17.2%, 4.7 pikë përqindje më e lartë se për vajzat (12.5%).

Pjesëmarrja e të rinjve në forcën e punës në Shqipëri ka treguar një rritje të vazhdueshme nga 45.7% në vitin 2016 në 56.9% në vitin 2023. Ndërkohë që të dyja gjinitë kanë treguar rritje të pjesëmarrjes, ekziston hendeku gjinor, ku pjesëmarrja e të rinjve mbetet vazhdimisht më e lartë se ajo e të rejave në të gjitha vitet, megjithatë ky hendek është ngushtuar me kalimin e kohës.

Në vitin 2023, hendeku ishte 9.8 pikë përqindjeje me 61.8% të të rinjve dhe 52% të të rejave që janë pjesë e forcës punëtore.

Shkalla e punësimit e të rinjve gjithashtu është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve, duke u rritur nga 32.4% në vitin 2016 në 44.2% në vitin 2023, duke reflektuar një rritje prej pothuajse 12% gjatë kësaj periudhe. Shkalla e punësimit e djemve në vitin 2023 (47.2%) është më e lartë se ajo e vajzave (41.3%), një trend i vazhdueshëm gjatë viteve. Megjithatë, vërehet një rënie e lehtë me 0.8 pikë përqindje e shkallës së punësimit të djemve krahasuar me vitin e kaluar.

Numri i të rinjve të vetëpunësuar paraqet një trend dinamik me luhatje të ndjeshme ndër vite. Në vitin 2023, ka një ulje prej 1.5 % në përqindjen e të rinjve të vetëpunësuar krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, ajo që vihet re këtë vit është një ulje e ndjeshme e numrit të djemve të vetëpunësuar krahasuar me vitet e tjera, këtë vit rënia është shumë e lartë 3.2%. Pabarazitë gjinore vazhdojnë, me meshkujt që mbajnë norma më të larta të vetëpunësimit sesa femrat, megjithëse të dyja gjinitë kanë parë ulje në vitet e fundit.

Të rinjtë përbëjnë 46.8% të totalit të popullsisë së papunë, duke reflektuar sfidën e konsiderueshme të papunësisë mbi ta, dhe duke sugjeruar se të rinjtë përballen me më shumë sfida në sigurimin e një vendi pune në krahasim me grupmoshat e tjera. Djemtë përballen me papunësi më të lartë në krahasim me totalin e popullsisë së papunë meshkuj. Ndërkohë, të rinjtë përbëjnë vetëm 19.6% të popullsisë totale të punësuar, më pak se një e pesta e të gjithë individëve të punësuar, duke nënvizuar nënperformimin e tyre në tregun e punës .

Të dhënat nga INSTAT për të rinjtë 15-29 të punësuar në rrezik të varfërie janë të padisponueshme.

Ndër të rinjtë e moshës 15-17 vjeç, 4.1% janë të punësuar, ku të rinjtë (2.9%) angazhohen më shumë në punësim në moshë të hershme krahasuar me të rejtat (1.2%), veçanërisht gjatë muajve të verës nga qershori deri në shtator.

Në Shqipëri, 1.2% e të rinjve banues ose 5363 individë [18], janë të rinj me aftësi të kufizuara, ku shumica (60%) janë të rinj meshkuj. Vetëm 2.1% (113 individë 18 ) e këtyre të rinjve drejtohen dhe përfitojnë nga shërbimet e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), dhe janë të punësuar përmes programeve si Programi për Nxitjen e Punësimit dhe persona të tjerë të punësuar.

Kjo shkallë e ulët e punësimit sugjeron që shumë të rinj me aftësi të kufizuara përballen me sfida të mëdha në hyrjen në tregun e punës, kryesisht për shkak të barrierave fizike, diskriminimit, mungesës së praktikave gjithëpërfshirëse të punësimit ose akomodimit të pamjaftueshëm në vendin e punës.

[18] Llogaritur nga të dhënat e marra nga Cens 2023, të rinjtë banues 15-29 vjeç sipas grupmoshës, paaftësisë, statusit dhe gjinisë

Përsa i përket të rinjve NEET, vetëm 7% (10,259 individë [19]) prej tyre janë të punësuar përmes programeve të AKPA (Persona të Punësuar dhe Programi për Nxitjen e Punësimit).

Në vitin 2023, shpenzimet për programet e nxitjes së punësimit ishin pafërsisht 626.8 milionë lekë Pavarësisht këtyre alokimeve, Shqipëria vazhdon të përballet me sfida në punësim, veçanërisht ndër të rinjtë.



[19] Kërkesë për informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive



## REKOMANDIME

Ky sesion synon të ofrojë rekomandime për politika, iniciativa dhe strategji për aktorët dhe institucionet që në mënyrë efektive të adresojnë dhe advokojnë për ndryshime pozitive të politikave në fushën e rinisë.

### Rekomandime për pjesëmarrjen politike të të rinjve

Dimensioni i pjesëmarrjes politike të të rinjve në Shqipëri ka shënuar progresin më të vogël, me indikatorë që tregojnë përmirësim minimal ndër vite. Të rinjtë vazhdojnë të jenë dukshëm të nënpërfaqësuar në rolet kryesore politike, si ministra, zëvendësministra, deputetë dhe kryetarë bashkie. Kjo mungesë e vazhdueshme e përfaqësimit të të rinjve nxjerr në pah barriera të sistemit që kufizojnë aksesin e tyre në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse. Nënpërfaqësimi i tyre në politikë jo vetëm që pengon zërat e tyre në qeverisje, por gjithashtu kufizon integrimin e perspektivave të reja dhe zgjidhjeve inovative në proceset e politikëbërjes.

Për të adresuar këtë situatë, janë të nevojshme strategji të targetuara. Rekomandimet e mëposhtme synojnë të inkurajojnë dhe rrisin pjesëmarrjen politike të të rinjve në vend:

#### • Rekomandime për Rritjen e Përfaqësimit të të Rinjve në Leadershipin Politik

Me afrimin e zgjedhjeve kombëtare të vitit 2025, qeveria duhet të shfrytëzojë këtë mundësi për të rritur pjesëmarrjen politike të të rinjve. Për të rritur efektivisht numrin e të rinjve në rolet udhëheqëse politike, është e domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse. Së pari, vendosja e kuotave për përfaqësimin e të rinjve mund të sigurojë që një përqindje e caktuar e kandidatëve dhe emërimeve në politikë janë nën një moshë të caktuar, duke nxjerrur gjithëpërfshirjen. Prezantimi i politikave që nxisin partitë politike të rekrutojnë aktivisht kandidatë të rinj dhe ofrimi i mbështetjes financiare përmes granteve mund të ndihmojë në zbutjen e barrierave me të cilat përballen të rinjtë gjatë kandidimit për poste politike. Gjithashtu, zhvillimi i programeve për leadershipin rinor të fokusuar në mentorim dhe aftësi thelbësore – të tilla si të folurit publik, analiza e politikave dhe menaxhimi i fushatave – mund të përgatisë të rinjtë për karrierë të suksesshme në politikë. Për më tepër, zbatimi i programeve të praktikave profesionale dhe stazheve brenda institucioneve qeveritare mund të ofrojë një eksperiencë të vlefshme praktike. Nxitja e edukimit qytetar në shkollë për të rritur ndërgjegjësimin mbi pjesëmarrjen politike dhe promovimi i rrjeteve rinore për bashkëpunim dhe advokim mund të stimulojë gjithashtu interesin e të rinjve. Shfrytëzimi teknologjisë për pjesëmarrje përmes rrjeteve sociale dhe platformave virtuale mund të ndihmojë në lidhjen e të rinjve me proceset politike. Ofrimi i çmimeve për liderat e rinj të suksesshëm, njeh arritjet e tyre dhe frymëzon të tjerët. Ndërkohë, përfaqësimi i të rinjve në organet vendimmarrëse përmes organeve këshillimore garanton që perspektivat e tyre të merren në konsideratë në politikëbërje.

Për të nxitur pjesëmarrjen politike në nivel lokal, duhet të zhvillohen iniciativa për të promovuar vajzat në role drejtuese, veçanërisht si kryetare bashkie. Ky proces mund të ndjekë modelin e suksesshëm kombëtar, ku gratë mbajnë një përqindje të konsiderueshme të posteve të ministave. Zbatimi i masave të ngjashme në nivel lokal do të inkurajojë balancën gjinore në udhëheqjen politike si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar dhe do t'u ofrojë vajzave mundësi më të mëdha për të kontribuar në qeverisje dhe vendimmarrje.

Gjithasthu, është i nevojshëm një koordinim më i mirëndërmjet Ministrit të Shtetit për Rininë, ministrive përkatëse në nivel kombëtar dhe bashkive në nivel lokal për të harmonizuar përpjekjet dhe për të prioritarizuar çështjet rinore. Çdo aspekt i politikave dhe qeverisjes në të gjitha ministrinë duhet të shikohet përmes një lente të fokusuar te të rinjtë, duke siguruar që politikatat të përshtaten për të adresuar nevojat dhe aspiratat specifike të të rinjve. Kjo qasje e koordinuar do të krjojë një mjedis më gjithëpërfshirës për të rinjtë në proceset vendimmarrëse si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal.

Një rëndësi më e madhe duhet t'i kushtohet rolit të organizatave rinore, duke njohur mundësitë dhe avantazhet që ato ofrojnë për të rinjtë. Edhe pse ato luajnë një rol vendimtar në mbështetjen dhe zhvillimin e të rinjve, ka shumë qytete, veçanërisht në ato më të voglat, ku mungojnë këto struktura të rëndësishme. Qeveria duhet të prezantojë programe që nxisin themelimin e organizatave rinore në të gjitha qytetet në nivel lokal . Këto organizata mund të punojnë në partneritet me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Këshillat Vendor Rinor (KVR) për të mobilizuar të rinjtë, duke u siguruar që ata të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe zhvillim.

Paralelisht me këtë, krijimi i qendrave rinore apo ambienteve multifunktionale në qytetet ku aktualisht mungojnë, do të plotësonte funksionet e KVR-ve dhe do t'u ofronte të rinjve më shumë mundësi për angazhim dhe pjesëmarrje.

- **Rekomandime për Përmirësimin e Përfaqësimit të të Rinjve, dhe Alokimin e Buxhetit për Rininë në Nivel Lokal**

Për të adresuar në mënyrë efektive nevojat dhe aspiratat e të rinjve, të gjitha bashkitë duhet të krijojnë struktura apo drejtori të dedikuara për të rinjtë, të ngjashme me ato të pranishme tashmë në Bashkinë e Tiranës. Kjo do të sigurojë që çështjet e të rinjve të marrin vëmendje të vazhdueshme. Shumë bashki tani kanë një specialist për rininë, por atyre u mungon një rol i drejtpërdrejtë që mund të ndikojë në buxhetin e bashkive për aktivitetet që lidhen me rininë. Gjithashtu, bashkitë duhet të përaktojnë zëra specifik në buxhet dhe të konsiderueshëm për programet dhe iniciativat që lidhen me të rinjtë. Ky financim i synuar mund të mbështesë zhvillimin e politikave dhe shërbimeve që fuqizojnë të rinjtë, nxisin pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse dhe adresojnë çështje kyçe si arsimit, punësimi dhe angazhimi qytetar në nivel lokal.



Inkurajimi i të rinjve për të qëndruar të angazhuar në komunitetet e tyre lokale kërkon një qasje shumëplanëshe që kombinon mundësi punësimi, incentiva dhe mbështetje afatgjata. Bashkitë mund të luajnë një rol kryesor në këtë drejtim duke krijuar mundësi tërheqëse për karrierë brenda administratave lokale, të cilat shpesh perceptohen si pozicione pune të sigurta dhe të qëndrueshme nga komuniteti. Punësimi i të rinjve në nivel lokal mund të nxitet më tej nëpërmjet ofrimit të kredive të buta për shtëpi për punonjësit e rinj në administratën lokale, duke i inkurajuar të rinjtë të qëndrojnë në Shqipëri dhe të kontribuojnë në komunitetet e tyre lokale.

Bashkitë duhet të kërkojnë në mënyrë aktive të bashkëpunojnë me institucione, organizata dhe donatorë të huaj dhe vendas për të siguruar fonde për projekte të lidhura me rininë. Kjo ofron një mjet alternativ për financimin e iniciativave rinore kur buxheti i bashkive është i kufizuar nga prioritetet e tjera të rëndësishme. Zbatimi i më shumë projekteve të fokusuara tek të rinjtë ofron mundësi të qëndrueshme për pjesëmarrjen e të rinjve.

- **Rekomandime për Aktivizimin e Strukturave Rinore për të Nxitur Përfshirjen e të Rinjve**

Për të garantuar efektivitetin e strukturave rinore në nivel lokal, masa të menjëhershme dhe proaktive janë thelbësore për aktivizimin e këtyre strukturave dhe maksimizimin e impaktit të tyre. Ndërsa shumë prej këtyre strukturave janë krijuar, pasiviteti i tyre në disa raste minimizon potencialin e tyre për të adresuar sfidat që lidhen me të rinjtë dhe për të promovuar pjesëmarrjen kuptimplotë të të rinjve.

Prandaj, është thelbësore të krijohet një kornizë që i mbështet këto struktura për t'u bërë funksionale përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe trajnimit për koordinatorët e strukturave rinore, duke i pajisur ata me aftësitë për të organizuar aktivitete dhe për të mobilizuar të rinjtë. Për më tepër, duhet të ofrohet mbështetje financiare dhe logjistike për të siguruar që këto struktura të kenë burimet e nevojshme për të planifikuar dhe zbatuar programe me ndikim. Inkurajimi i partneriteteve midis strukturave rinore dhe organizatave lokale rinore mund të forcojë gjithashtu angazhimin në nivel bazë të komunitetit. Për të siguruar aktivitete të qëndrueshëm, duhet të krijohen mekanizma monitorimi dhe raportimi, duke vendosur synime dhe pritshmëri të qarta, si dhe duke ofruar raportim publik për progresin në çështjet e rinisë.

- **Rekomandime për Nxitjen e Mbledhjes dhe Raportimit të Rregullt të të Dhënave për të Rinjtë**

Duhet të sigurohet që të dhëna të plota mbi pjesëmarrjen politike të të rinjve të mblihen, analizohen dhe raportohen rregullisht. Ky informacion është i rëndësishëm për analizimin e progresit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe formulimin e politikave të mbështetura në të dhëna dhe prova.



## Rekomandime për pjesëmarrjen sociale të të rinjve

- Duhet të ndërtohet një sistem i unifikuar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave për të zhvilluar iniciativa mbështetëse të synuara për të rinjtë vulnerabël

Në vijim të mungesës së të dhënave në dimensionin social, veçanërisht për të rinjtë e varfër dhe të rinjtë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale, është thelbësore krijimi i një sistemi të integruar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave. Një sistem transparent dhe i besueshëm për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për të rinjtë në disavantazh ekonomik dhe ata në programet e mbrojtjes sociale do të mundësonte identifikimin e saktë të të rinjve në rrezik varfërie ose të rinjve në kategorinë NEET, dhe do të lehtësonte ofrimin e mbështetjes së targetuar dhe efektive. Nëpërmjet këtyre të dhënave, politikëbërësit mund të trajtojnë pabarazitë socio-ekonomike në mënyrë më efektive dhe të ofrojnë ndërhyrje të përshtatura që mbështesin të rinjtë në kapërcimin e varfërisë dhe arritjen e pavarësisë ekonomike dhe sociale.

Është e rëndësishme që sistemi të funksionojë me transparencë të plotë dhe të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave të tyre për të krijuar besim tek të rinjtë. Kjo do të inkurajojë angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, duke ditur se informacioni i mbledhur përdoret me përgjegjësi dhe në dobi të tyre. Për më tepër, sistemi duhet të jetë i aksesueshëm dhe miqësor për përdoruesit, duke i lejuar të rinjtë dhe aktorët përkatës të kuptojnë dhe të përdorin të dhënat për të përmirësuar politikat dhe programet e hartuara.

- Të prioritetizohet mbështetja për të rinjtë në rrezik varfërie, me fokus kryesor tek vajzat

Duhet të ndërmerren iniciativa të dedikuara për të adresuar nevojat e të rinjve të varfër dhe të atyre në rrezik varfërie, veçanërisht të vajzave të cilat përballen me nivele të larta të vështirësive ekonomike. Masat parandaluese duhet të përfshijnë mbështetje financiare gjithëpërfshirëse, ndihmë për strehim, akses në shërbime shëndetësore të përballueshme, programe për zhvillimin e aftësive, programe punësimi dhe shërbim këshillimi për të zbutur rreziqet e varfërisë dhe përjashtimit social.

Një strategji kyçe për të luftuar varfërinë e të rinjve përfshin identifikimin dhe integrimin e të rinjve në rrezik varfërie në programe të targetuara, përmes përpjekjeve që fillojnë në nivel lokal dhe zgjerohen në të gjithë vendin. Vëmendje e veçantë duhet t'ju kushtohet të rinjve të punësuar në punë me paga të ulëta, të cilët nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet kryesore të jetesës. Një grup shpesh i anashkuar, por në rrezik të lartë për të rënë në varfëri, të cilët kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm ekonomik.

Është thelbësore të krijohen mundësi punësimi që përputhen me kualifikimet dhe aspiratat e të rinjve dhe ofrojnë kompensim të denjë, duke siguruar që të rinjtë të kenë akses në karriera përmbushëse që mbështesin mirëqenien dhe pavarësinë e tyre financiare, duke kontribuar për një jetë me dinjitet. Bashkëpunimi me sektorin privat për të krijuar mundësi pune dhe nisma për zhvillimin e aftësive është shumë i rëndësishëm për nxitjen e stabilitetit ekonomik afatgjatë.

Për më tepër, fushatat për ndërgjegjësimin publik dhe dialogu politik duhet të normalizojnë bisedat mbi varfërinë e të rinjve, duke theksuar vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë dhe të rinjtë e punësuar në rrezik varfërie. Duke i trajtuar hapur këto çështje, shoqëria mund të krijojë ndjeshmëri, të shtyj për reforma politike dhe të advokojë për përmirësimin e pagave, praktika të barabarta dhe të drejta pune dhe zgjerimin e aksesit në shërbime thelbësore për këto grupe vulnerabël.

- **Të fuqizohen programet e mbrojtjes sociale për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse për të rinjtë**

Të forcohen dhe të përmirësohen programet e mirëqenies sociale për të siguruar që të rinjtë në rrezik varfërie, duke përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe nga shtresa të pafavorizuara, të marrin mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të kenë akses në shërbime thelbësore, si arsimi, kujdesi shëndetësor dhe mundësi për punësim.

Nevojat për arsimim të të rinjve në sistemin e mirëqenies sociale duhet të jenë prioritet, duke siguruar që ata të kenë akses të barabartë në programet e arsimit formal dhe joformal. Monitorimi duhet të rritet për të parandaluar braktisjen e shkollës. Fuqizimi i sistemeve mbështetëse, si punonjësit social, këshilluesit dhe mentorimi nga bashkëmoshatarët, është i nevojshëm për të inkurajuar të rinjtë në sistemin e mirëqenies sociale që të përfundojnë arsimin e mesëm dhe të lartë.

Sistemi i mirëqenies sociale në Shqipëri ofron disa shërbime thelbësore, por megjithatë ka hapësira të konsiderueshme në disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse në të gjithë vendin. Shumë të rinj, veçanërisht në zonat rurale dhe jo vetëm, nuk kanë akses në shërbimet kritike thelbësore. Për të adresuar këtë, qeveria duhet të bashkëpunojë në mënyrë më efektive me sipërmarrjet sociale për të plotësuar këto hapësira në shërbime. Duke institucionalizuar partneritetet përmes një kuadri ligjor, të frymëzuar nga modele të tilla si ai i Italisë, qeveria mund të shfrytëzojë kapacitetin e sipërmarrjeve sociale për të ofruar shërbime që nuk mund t'i realizojë vetë. Këto partneritete duhet të përfshijnë bashkë-dizenjimin dhe bashkë-ofrimin e shërbimeve inovative dhe të përshtatura që adresojnë nevojat e paplotësuara në arsim, punësim, shëndet mendor dhe përfshirje.

- **Të promovohet dhe inkurajohet arsimi profesional midis të rinjve**

Arsimi profesional ofron trajnim të specializuar në fusha si teknologjia, shërbimet shëndetësore, apo tregtia, duke përgatitur të rinjtë për karriera që mund të mos kërkojnë një diplomë universitare, por janë shumë të kërkuara e në tregun punës. Kjo u mundëson atyre të hyjnë më shpejt në tregun e punës dhe me një grup aftësish përkatëse. Prandaj, është e rëndësishme të inkurajohet arsimin profesional dhe mundësitë e të mësuarit joformal midis të rinjve. Duhet të investohet në zgjerimin e programeve të formimit profesional që përputhen me kërkesat aktuale të tregut të punës, duke siguruar që të rinjtë të pajisen me aftësitë që kërkojnë punëdhënësit.

Qeveria duhet gjithashtu t'i bëjë këto programe më të aksesueshme duke ofruar mbështetje financiare, si bursa ose subvencione, për të reduktuar barrierat për të rinjtë vulnerabël.

Gjithashtu është thelbësore që shkollat e arsimit profesional të kenë ambiente të përshtatshme, pajisje moderne, mjete, materiale dhe akses në produkte standarte të industrisë, të cilat janë të domosdoshme për të ofruar në mënyrë efektive trajnime dhe arsim praktik. Kjo siguron që studentët të perfeksionojnë aftësitë e tyre dhe të përgatiten për kërkesat e tregut të punës. Për më tepër, nxitja e partneriteteve midis institucioneve arsimore dhe industrive mund të ndihmojë në përshtatjen e kurrikulave me nevojat e tregut të punës, si dhe në ofrimin e trajnimeve dhe praktikave profesionale.

Qeveria duhet gjithashtu të nxisë ndërgjegjësimin për arsimin profesional si një drejtim karriere i vlefshëm dhe i qëndrueshëm, me qëllim ndryshimin e perceptimeve të shoqërisë, dhe inkurajimin e më shumë të rinjve për të ndjekur këto fusha. Në këtë kontekst, vetëm 2.3% e vajzave janë të regjistruara në arsimin profesional, krahasuar me 12.1% të djemve, prandaj është e nevojshme të prezantohen fushata të synuara për të promovuar arsimin profesional tek të rejtat dhe të ofrohen stimuj si bursa dhe modele suksesi të vajzave në sektorët profesional.

- **Të Përmirësohet Sistemi Arsimor në Shqipëri**

Për të inkurajuar më shumë të rinj të qëndrojnë dhe të ndjekin studimet e tyre në Shqipëri, është e rëndësishme të përmirësohet cilësia dhe përmbajtja e kurrikulave arsimore, duke u siguruar që ato të përputhen me standardet globale, veçanërisht përmes përfshirjes së digjitalizimit dhe kornizave moderne teorike. Për më tepër, është e rëndësishme të mundësohet që diplomat njihen si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Gjithashtu, duhet të ofrohen më shumë bursa dhe stimuj financiarë për të rinjtë nga shtresat e pafavorizuara për të marrë pjesë në arsim cilësor dhe për të zvogëluar shkallën e braktisjes së shkollës për shkak të barrierave financiare.

Megjithëse programe trajnimi të fokusuara në zhvillimin e aftësive digjitale dhe të kodimit janë të disponueshme në Tiranë dhe në disa qytete të tjera, ato mbeten kryesisht të paarrtshme në qytetet më të vogla dhe zonat rurale. Gjatë takimeve konsultuese me të rinjtë, shumë prej tyre shprehën interes të madh për të marrë pjesë në këto programe, duke theksuar nevojën për të decentralizuar këto mundësi dhe për t'i vënë ato në dispozicion për të gjithë të rinjtë, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Një çështje tjetër e identifikuar gjatë këtyre diskutimeve është mungesa e konsiderushme e informacionit tek të rinjtë. Pavarësisht se jetojnë në një epokë të dominuar nga teknologjia dhe me akses të bollshëm në informacion, shumë të rinj mbeten të painformuar mbi mundësitë ekzistente për përfshirjen e tyre. Kjo mungesë informacioni mund vijë nga faktorë të ndryshëm, si mosditja ku të kërkojnë informacion të besueshëm, mosshfrytëzimi efektiv i burimeve të disponueshme, por vërhet gjithashtu dhe një mosinteresim i përgjithshëm nga të rinjtë për përfshirje.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon jo vetëm përmirësimin e aksesueshmërisë për pjesëmarrje në trajnime, por edhe nxitjen e kulturës së alfabetizimit digjital për të fuqizuar të rinjtë për të shfrytëzuar plotësisht burimet dhe mundësitë përrreth tyre. Ofrimi i informacionit dhe mundësive për të rinjtë, nëpërmjet programeve të integruara në shkolla, mund të jetë një mënyrë për të siguruar që të gjithë të rinjtë të kenë akses në informacion.

- **Mundësi të barabarta arsimimi dhe punësimi për të gjithë të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, me fokus të veçantë tek të rinjtë vulnerabël.**

Nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse të arsimit, studentët me aftësi ndryshe duhet të integrohen në shkollat e zakonshme duke ofruar burime të përshtatura, teknologji ndihmëse dhe infrastrukturë të aksesueshme. Edukatorët duhet të marrin trajnim të specializuar mbi metodat e mësimdhënies adaptuese dhe ndërgjegjësimin mbi aftësitë ndryshe për të mbështetur në mënyrë efektive nevojat e ndryshme të të mësuarit. Programet e personalizuara që ofrojnë mësim një-një, orare fleksibël dhe materiale të përshtatura janë thelbësore për të adresuar hapësirat në alfabetizim dhe për ta bërë më të lehtë për të rinjtë ndjekjen e arsimit.

Përshtatja e formimit profesional për këto grupe me kërkesat e tregut dhe nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse të punësimit nëpërmjet partneriteteve publike-private mund të ndihmojë në ngushtimin e hendekut midis arsimit dhe punësimit të të rinjve me aftësi ndryshe. Gjithashtu programet e mentorimit, këshillimi për karrierë dhe mbështetja pas arsimit, si shërbimet e punësimit dhe praktikat profesionale janë thelbësore për t'i udhëhequr këta të rinj drejt karrierave të suksesshme. Fushatat ndërgjegjësuese për të luftuar stigmatizimin dhe për të nxitur mbështetjen nga komuniteti janë po aq të rëndësishme, krahas bashkëpunimeve me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë lokal për të amplifikuar përpjekjet.

- **Ndërmarrja e politikave dhe masave për të ulur numrin e të rinjve në burgje dhe për të mbështetur ri-integrimin e tyre gjatë dhe pas burgimit**

Për të reduktuar mundësitë që të rinjtë të hyjnë ose të rihyjnë në sistemin e burgjeve, është thelbësore një qasje gjithëpërfshirëse që fokusohet në parandalim, rehabilitim dhe riintegrim. Masat parandaluese duhet të prioritetizojnë adresimin e shkaqeve kryesore të delikuencës së të rinjve – si faktorët socialë, ekonomikë, arsimorë dhe psikologjikë – përmes iniciativave të targetuara. Këto mund të përfshijnë programe mentorimi, akses të përmirësuar në arsim në zonat e thella ose rurale, dhe mbështetje financiare dhe sociale për familjet në nevojë. Po aq e rëndësishme është adresimi i çështjeve themelore si sfidat e shëndetit mendor dhe abuzimi me substancat, të cilat shpesh çojnë në sjellje kriminale. Qeveria duhet të sigurojë disponueshmërinë e shërbimeve të aksesueshme për shëndetin mendor, programe të ndërhyrjes së hershme dhe trajtime gjithëpërfshirëse për varësitë, të përshtatura për nevojat e të rinjve në rrezik. Për ata të rinj që tashmë janë në sistemin e burgjeve, investimi në programe arsimi dhe formimi profesional të fokusuar në aftësitë jetësore, punësim dhe sipërmarrje mund të ndihmojnë në rehabilitimin dhe përgatitjen e të rinjve për riintegrim në shoqëri. Mbështetja pas lirimit është po aq e domosdoshme, duke përfshirë mentorim, asistencë për strehim të qëndrueshëm dhe mundësi punësimi, shoqëruar me incentiva dhe stimuj për bizneset që të punësojnë të rinj të rehabilituar.



## Rekomandime për pjesëmarrjen ekonomike të të rinjve

Prezantimi dhe zbatimi i strategjive si Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe Garancia Rinore përfaqësojnë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të kushteve më të favorshme në tregun e punës për të rinjtë në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht progresit dhe hapave pozitivë të ndërmarrë gjatë viteve të fundit, në vitin 2023 disa tregues të pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve kanë shfaqur një rënie shqetësuese. Kjo nxjerr në pah aspekte shqetësuese që kërkojnë vëmendje të fokusuar dhe veprim të menjëhershëm për të siguruar progres gjithëpërfshirës dhe me ndikim.

- **Rekomandime për uljen e Numrit të të Rinjve në NEET**

Shkalla e NEET në Shqipëri mbetet e lartë, mbi 24%, ndërsa papunësia tejkalon 22%. Për të adresuar këto sfida, institucionet përgjegjëse duhet të përqendrohen në zbatimin efektiv të iniciativave kryesore të parashikuara në Garancinë Rinore dhe Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Një pikënisje e rëndësishme është identifikimi efektiv i të rinjve NEET, duke filluar me një qasje të mirëpërcaktuar, gjithëpërfshirëse dhe të synuar që kombinon përpjekjet në nivel lokal me një koordinim të vazhdueshëm kombëtar. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet dhe komunitetet lokale duke përdorur metoda formale dhe informale është thelbësor për të siguruar që të mos anashkalohet asnjë i ri NEET. Kjo është veçantërisht e rëndësishme sepse të rinjtë NEET shpesh i përkasin kategorive të ndryshme të grupeve vulnerabël, dhe është e nevojshme një strategji gjithëpërfshirëse për të siguruar që të gjithë të identifikohen dhe të përfshihen. Trajnimi dhe zhvillimi kapaciteteve të aktorëve lokal luan një rol vendimtar në adresimin e sfidave të vërejtura gjatë identifikimit të të rinjve, si dhe për të siguruar zbatimin efektiv të gjithë procesit.

- Programet e ndërhyrjes së hershme në shkolla mund të ndihmojnë në identifikimin e studentëve që janë në rrezik për t'u bërë NEET, duke lejuar ofrimin e mbështetjes në kohë.
- Gjithashtu, si pjesë e zbatimit të kësaj strategjie, është thelbësore që përmes Garancisë Rinore të sigurohen mundësi punësimicilësore, duke siguruar që vendet e punës të ofruara të përmbushin standardet e cilësisë dhe të përputhen me nevojat dhe pritshmëritë e të rinjve. Kombinimi i mundësive të punësimit për të rinjtë me iniciativa mbështetëse si skemat e kredive të buta për shtëpi ose stimuj të tjerë financiarë mund të përmirësojnë stabilitetin dhe angazhimin e tyre afatgjatë.
- Rritja e ndërgjegjësimit midis të rinjve për ekzistencën e këtyre programeve është po aq i rëndësishëm. Një komunikim i qartë dhe burime informacioni të aksesueshme do të sigurojnë që të rinjtë të dinë ku të drejtohen për mbështetje dhe udhëzim kur është e nevojshme.

- **Rekomandime për Përmirësimin e Mundësive të Punësimit për të Rinjtë**

Për të adresuar sfidën e vazhdueshme të papunësisë së të rinjve, veçanërisht papunësinë afatgjatë, përpjekjet duhet të përqendrohen në nxitjen e krijimit të vendeve të punës në sektore me zhvillim të lartë si teknologjia, energjia e gjelbër dhe industritë kreative. Kjo mund të arrihet përmes partneriteteve publike-private, investimeve strategjike në infrastrukturë dhe incentivave për bizneset që punësojnë të rinj.

- Duhet të prezantohen subvencione të synuara për punëdhënësit për të nxitur punësimin e të rinjve të papunë afatgjatë, për të kontribuar në uljen e papunësisë së të rinjve. Këto subvencione mund të zvogëlojnë rrezikun për punëdhënësit që punësojnë kandidatë me më pak eksperiencë.
- Duhet të krijohen shërbime të specializuara për punësimin e të rinjve, të cilat u përshtaten nevojave unike të punëkërkuësve të rinj. Gjithashtu, duhet të ofrohet këshillim për karrierën, orientim për kërkimin për punë që përputhet me aftësitë dhe aspiratat e të rinjve, si dhe mundësi për trajnim për të lehtësuar tranzicionin e të rinjve në forcën e punës.
- Për më tepër, programet e trajnimit për zhvillimin e aftësive, duhet të përafrohen me kërkesat e tregut për aftësitë digjitale, aftësitë e buta dhe trajnimin profesional për të pajisur të rinjtë me aftësitë e nevojshme për mundësitë e punës të disponueshme.
- Duhet të krijohen kushte pune më fleksibël, si pozicione pune me kohë të pjesshme ose puna nga shtëpia, të cilat mund t'i ndihmojnë të rinjtë të balancojnë punën me arsimin ose përgjegjësi të tjera dhe të hyjnë më herët në tregun e punës.
- Programe të rikualifikimit dhe të përmirësimit të aftësive duhet të vihen në dispozicion për të rinjtë e papunë afatgjatë. Këto programe duhet të përqendrohen në industritë me kërkesë të lartë për punë dhe të pajisin pjesëmarrësit me aftësitë e nevojshme për integrim të menjëhershëm në tregun e punës.
- Të rinjve të papunë afatgjatë duhet t'u ofrohet gjithashtu ndihmë e personalizuar për të kërkuar punë, duke përfshirë këshillim për karrierën, seminare për shkrimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista punë. Një mbështetje e tillë mund të ndihmojë në adresimin e barrierave specifike ndaj punësimit dhe të lehtësojë kthimin e tyre në tregun e punës.
- Efektet sociale dhe psikologjike të papunësisë afatgjatë duhet të njihen dhe të pranohen, si dhe duhet të shoqërohen me shërbimet e duhura për shëndetin mendor dhe mbështetje sociale për të ndihmuar të rinjtë të rifitojnë besimin, të jenë rezilient dhe të rikthehen në punësim.
- Për të rritur shkallën e punësimit të të rinjve me aftësi ndryshe, është thelbësore të promovohen vendet e punës gjithëpërfshirëse, si dhe të trajnohen punëdhënësit për të mbështetur të rinjtë dhe për t'i bërë vendet e punës më të aksesueshme. Gjithashtu, duhet të zhvillohen programe profesionale të fokusuara në industritë ku këta individë mund të jenë të suksesshëm, duke i shoqëruar me mjedise pune mbështetëse dhe të adaptueshme. Fushatat e ndërgjegjësimit publik janë gjithashtu të nevojshme për të reduktuar stigmatizimin dhe për të inkurajuar punëdhënësit që të njohin kontributet e vlefshme që të rinjtë me aftësi ndryshe sjellin në vendin e punës.

- Punësimi i hershëm (15-17 vjeç) luan një rol të rëndësishëm për të ndihmuar të rinjtë të zhvillojnë aftësi thelbësore të jetës, si përgjegjësia, angazhimi social dhe pavarësia. Për të mbështetur rritjen e tyre dhe për të nxitur zhvillimin e hershëm individual dhe pavarësinë financiare, është me rëndësi të promovohen mundësi pune me kohë të pjesshme, të sigurta dhe të rregulluara që përputhen dhe respektojnë ligjet e punës dhe i japin përparësi të mësuarit dhe jo shfrytëzimit të të rinjve. Për më tepër, forcimi i programeve të tranzicionit nga shkolla në punë, si praktikatat profesionale dhe mësimi i bazuar në punë, mund të ofrojë përvojë të vlefshme praktike për të kaluar në mënyrë efektive hendekun midis arsimit dhe punësimit. Këto nisma duhet të sigurojnë që punësimi i hershëm të jenë kuptimplotë, të zhvillojë aftësi dhe të mos pengoj arsimimin e të rinjve.

### • Rekomandime për Promovimin dhe Nxitjen e Vetëpunësimit midis të Rinjve

Për të nxitur vetëpunësimin midis të rinjve në Shqipëri, është thelbësore të adresohen sfidat e identifikimit të mundësive, navigimit të proceseve komplekse të aplikimit dhe kultivimit të interesit për iniciativat sipërmarrëse.

- Përpjekjet duhet të përqendrohen në lehtësimin e aksesit në mundësi dhe rritjen e interesit për sipërmarrjen. Duhet të krijohet një platformë online e centralizuar për të konsoliduar gjithë informacionin mbi programet sipërmarrëse në dispozicion, grantet, trajnimet dhe mundësitë për mentorim. Kjo platformë duhet të jetë e lehtë për tu përdorur, të përditësohet rregullisht dhe të promovohet gjerësisht tek të rinjtë për të siguruar akses dhe ndërgjegjësim.
- Ka nevojë për thjeshtimin e proceseve të aplikimit duke i digjitalizuar dhe lehtësuar procedurat për mbështetje financiare, trajnim dhe pjesëmarrje në programe akselerimi. Udhëzime hap pas hapi dhe formatet e nevojshme duhet të ofrohen për të ndihmuar të rinjtë të orientohen dhe të plotësojnë me lehtësi procesin e aplikimit.
- Për të gjeneruar interes dhe entuziazëm për sipërmarrjen, duhet të ndërmerren fushata ndërgjegjësuese, që promovojnë histori suksesi dhe tregojnë përfitimet e mundshme të iniciativave sipërmarrëse. Këto fushata mund të përdorin rrjetet sociale dhe komunitare, si dhe konkurset për sipërmarrjen që ofrojnë shpërblime të prekshme për të frymëzuar pjesëmarrjen.
- Përparësi duhet ti jepet dhe mbështetjes praktike nëpërmjet shërbimeve këshilluese, si zyrat e ndihmës me një ndalesë, për të ndihmuar të rinjtë në identifikimin e mundësive dhe kuptimin e kërkesave të aplikimit. Duhet të krijohen gjithashtu rrjete dhe workshope të udhëhequra nga kolegët për të ndërtuar një mjedis frymëzues të të mësuarit të përbashkët.
- Për të krijuar një ekosistem sipërmarrës miqësor ndaj të rinjve, është e nevojshme të reduktuohen barrierat burokratike duke zbatuar sisteme të shpejta për iniciativat e udhëhequra nga të rinjtë dhe minimizuar vonesat procedurale.
- Duhet të ndërtohen partneritete me institucionet arsimore me qëllim integrimin e sipërmarrjes në kurrikul, me aktivitete praktike si simulimet e biznesit dhe të mësuarit e bazuar në projekte për të kultivuar mendësinë sipërmarrëse që në moshë të re.





# SHTOJCA 1: SHËNIME METODOLOGJIKE

Që nga viti 2016, u përzgjedh një grup indikatorësh, bazuar në një proces analitik të përbërë nga hulumtime të thelluara në zyrë si dhe konsultime me eksperët. Këtë vit janë prezantuar disa indikatorë të rinj për të matur më mirë pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve. Në tabelën e mëposhtme janë renditur të gjithë indikatorët, mënyra e llogaritjes dhe burimet e të dhënave.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Ministrit e rinj në qeveri	Numri i ministrave të rinj (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministereve të reja femra (15-29) / Numri total i ministrave	Numri i ministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i ministrave	Hulumtim
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	Numri i zëvendësministrave të rinj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i femrave të reja zëvendësministre (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Numri i zëvendësministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave	Hulumtim
Deputetët e rinj në parlament	Numri i deputetëve të rinj (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputeteve të reja femra (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputetëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i deputetëve	Hulumtim
Kryebashkiakë të rinj	Numri i kryetarëve të rinj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetareve bashkiake të reja femra (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetarëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Hulumtim
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	Mesatarja e (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Instagram / Numri total i institucioneve publike në nivel qendror + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Facebook / numri total i institucioneve publike në nivel qendror) + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë një faqe internet (website) / Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në nivel qendror)	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Hulumtim

INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	Mesatarja e (Numri i bashkive që kanë Instagram / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë Facebook / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë një faqe internet / Numri total i bashkive)	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Hulumtim
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar	Numri i strukturave rinore në nivel kombëtar	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve dhe hulumtimi në zyrë
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	Numri i bashkive që kanë strukturë rinore (këshilla, parlamente, sindikata) / Numri total i bashkive.	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Bashkitë dhe Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve
Të Rinj të Punësuar në Administratën Publike në Nivel Lokal	Numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkitë e Shqipërisë / Numri total i të punësuarve në bashkitë e Shqipërisë	Numri i femrave të reja (18-29) të punësuar në bashkitë e Shqipërisë / Numri total i femrave të reja të punësuar në bashkitë e Shqipërisë	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të punësuar në bashkitë e Shqipërisë / Numri total i të rinjve meshkuj të punësuar në bashkitë e Shqipërisë	Llogaritur nga hulumtuesi sipas të dhënave të ofruara nga bashkitë e Shqipërisë (n=50)
Të Rinj në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në Administratën Publike në Nivel Lokal	Numri i të rinjve (18-29) në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë/ Numri total i të punësuarve në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë	Numri i femrave të reja (18-29) në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë / Numri total femrave të reja në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë/Numri total i të rinjve meshkuj në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse në bashkitë e Shqipërisë	Llogaritur nga hulumtuesi sipas të dhënave të ofruara nga bashkitë e Shqipërisë (n=50)
% e Buxhetit të Bashkive Dedikuar Rinisë	Mesatare e % të Buxheteve të Bashkive që e kanë ofruar këtë informacion	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Llogaritur nga hulumtuesi sipas të dhënave të ofruara nga bashkitë e Shqipërisë (n=14)

DIMENSIONI I PJESËMARRJES EKONOMIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Shkalla e NEET	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Indeksi i Barazisë Gjinore (GPI) në NEET	Përqindja e NEET e femrave të reja (15-29) / Përqindja e NEET e të rinjve meshkuj (15-29)	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas informacionit të ofruar nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e punësimit të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Përqindja e të rinjtve të vetëpunësuar	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)

INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Raporti i Papunësisë së të Rinjve ndaj Popullsisë Totale	Numri i të rinjve (15-29) të papunësuar / Popullsia totale e papunësuar	Numri i femrave të reja (15-29) të papunësuar / Popullsia totale e femrave të papunësuar	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) të papunësuar / Popullsia totale e meshkujve të papunësuar	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas informacionit në publikimet e Institutit Kombëtar të Statistikave në Shqipëri (INSTAT), Tregu i Punës 2023
Raporti i Punësimit të të Rinjve ndaj Popullsisë Totale	Numri i të rinjve (15-29) të punësuar / Popullsia totale e punësuar	Numri i femrave të reja (15-29) të punësuar / Popullsia totale e femrave të punësuar	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) të punësuar / Popullsia totale e meshkujve të punësuar	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas informacionit në publikimet e Institutit Kombëtar të Statistikave në Shqipëri (INSTAT), Tregu i Punës 2023
Të Rinj 15-17 vjeç të Angazhuar në Punë	Numri i të rinjve (15-17) të punësuar / Popullsia totale e të rinjve (15-17)	Numri i femrave të reja (15-17) të punësuar / Popullsia totale e të rinjve (15-17)	Numri i të rinjve meshkuj (15-17) të punësuar / Popullsia totale e të rinjve (15-17)	Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Shpenzimet për Programet e Nxitjes së Punësimit	Shuma totale në lekë	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Të dhënat të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

SOCIAL PARTICIPATION DIMENSION	DATA CALCULATION METHOD			SOURCE OF DATA
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Të rinj në rrezik varfërie	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinj në burgje	Numri i të rinjve (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i femrave të reja (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Të rinj pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtuar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale	Të rinj (15-29) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike / Totali personave përfitues të skemës së ndihmës ekonomike	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e Shkrim-Leximit	Numri i të rinjve (15-29) që dinë shkrim-lexim / Numri i total i të rinjve (15-29) banues në Shqipëri	Numri i femrave të reja (15-29) që dinë shkrim-lexim / Numri total i femrave të reja (15-29) banuese në Shqipëri	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) që dinë shkrim-lexim / Numri total i të rinjve meshkuj (15-29) banues në Shqipëri	Të dhënat të llogaritura nga hulumtuesi sipas informacionit të publikuar në CENS 2023
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Detyrueshëm	Numri i të rinjve të regjistruar në arsimin e detyrueshëm / Numri total i të rinjve të grupmoshës (6-15) banues në Shqipëri	Numri i femrave të reja të regjistruara në arsimin e detyrueshëm / Numri total i femrave të reja të grupmoshës (6-15) banuese në Shqipëri	Numri i të rinjve meshkuj të regjistruar në arsimin e detyrueshëm / Numri total i të rinjmeshkuj të grupmoshës (6-15) banues në Shqipëri	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas statistikave dhe informacionit të publikuar nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri, CENS 2023 dhe Statistikat e Regjistrimeve në Arsim

INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Mesëm	Numri i të rinjve të regjistruar në arsimin e mesëm / Numri total i të rinjve të grupmoshës (15-18) banues në Shqipëri	Numri i femrave të reja të regjistruara në arsimin e mesëm / Numri total i femrave të reja të grupmoshës (15-18) banuese në Shqipëri	Numri i të rinjve meshkuj të regjistruar në arsimin e mesëm / Numri total i të rinjve meshkuj të grupmoshës (15-18) banues në Shqipëri	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas statistikave dhe informacionit të publikuar nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri, CENS 2023 dhe Statistikat e Regjistrimeve në Arsim
Braktisja e shkollës së mesme	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Indeksi i Barazisë Gjinore (GPI) në Arsimin e Mesëm	Përqindja e femrave të reja të regjistruara në arsimin e mesëm / Përqindja e meshkujve të rinj të regjistruar në arsimin e mesëm	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas informacionit të indikatorëve të llogaritur më sipër
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin Profesional	Numri i të rinjve të regjistruar në AFP / Numri total i të rinjve të grupmoshës (15-18) banues në Shqipëri	Numri i femra të reja të regjistruara në AFP / Numri total i femrave të reja të grupmoshës (15-18) banuese në Shqipëri	Numri i të rinjve meshkuj të regjistruar në AFP / Numri total i të rinjve meshkuj të grupmoshës (15-18) banues në Shqipëri	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas statistikave dhe informacionit të publikuar nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri, CENS 2023 dhe Statistikat e Regjistrimeve në Arsim
Të Rinj të Diplomuar në Arsimin Profesional	Numri i të rinjve të diplomuar në AFP/ Numri total i të rinjve të grupmoshës përkatëse (18-24) banues në Shqipëri	Numri i të femrave të reja të diplomuara në AFP/ Numri total i femrave të reja, të grupmoshës përkatëse (18-24) banues në Shqipëri	Numri i të rinjve meshkuj të diplomuar në AFP/ Numri total i të rinjve meshkuj të grupmoshës përkatëse (18-24) banues në Shqipëri	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas statistikave dhe informacionit të publikuar nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri, CENS 2023 dhe Databaza e INSTAT
Të rinj të regjistruar në arsimin e lartë	Numri të rinjve (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë/Numri total i të rinjve (18-29)	Numri i femrave të reja (18-29) të regjistruara në Arsimin e Lartë/Numri total i femrave të reja (18-29).	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë/Numri total i të rinjve meshkuj (18-29).	Informacioni i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinj të diplomuar në arsimin e lartë	Numri i të rinjve (18-29) të diplomuar në 2023 / Numri i të rinjve (18-29) të regjistruar në 2023	Numri i femrave të reja (18-29) të diplomuara në 2023 / Numri i të femrave të reja (18-29) të regjistruara në 2023	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të diplomuar në 2023/ Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të regjistruar në 2022	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)

INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Të Rinj të me Arsim të Avancuar	Numri i të rinjve (25-29) të diplomuar me master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i të rinjve (25-29) më 1 janar 2023	Numri i femrave të reja (25-29) të diplomuara me master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i femrave të reja (25-29) në 1 janar 2023	Numri i të rinjve meshkuj (25-29) të diplomuar me një master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i të rinjve meshkuj (25-29) në 1 janar 2023	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe informacionit të disponueshëm në databazën e INSTAT
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Buxheti i Qeverisë për Programet e Mbrojtjes Sociale	Shuma totale në lekë	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Shërbimi Social Shtetëror





# PARTERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

---



**Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10, ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri**



**partners@partnersalbania.org**



**www.partnersalbania.org**